

**UDHËZIM**  
**Nr. 27, datë 2.8.2022**

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE, AFATEVE TË APLIKIMIT, SHQYRTIMIT DHE  
PROCEDURAT E MASËS DHE MËNYRËS SË FINANCIMIT TË STUDENTËVE TË  
SHKËLQYER DHE ATYRE QË NDJEKIN PROGRAMET E STUDIMIT QË PËRBËJNË  
PRIORITET KOMBËTAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të pikës 6, të vendimit nr. 386, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjes financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve, që ndjekin këto programe në institucione publike të arsimit të lartë”,

**UDHËZOJ:**

1. Studentët shtetas shqiptarë që regjistrohen në vitin akademik 2022–2023, e në vijim në institucionet e arsimit të lartë publik, që cilët plotësojnë kriteret e parashikuara në pikën 2, të vendimit nr. 386, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë”, aplikojnë për mbështetje financiare pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, brenda datës 30 janar të vitit akademik që pranohen në institucionet e arsimit të lartë publike.

2. Për secilin prej kërkesave për financim të paraqitura nga studentët, që janë pranuar në një institucion publik të arsimit të lartë, aplikojnë kandidatët që përmbushin kriteret si më poshtë:

- a) studentët me notë mesatare që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare 10.00;
- b) studentët që në secilin prej provimeve kombëtare të detyruara të Maturës Shtetërore janë vlerësuar me jo më pak se nota e shkallëzuar 9.5–10.00;
- c) studentët fitues, të njërit prej tri çmimeve të para në olimpiadat ndërkombëtare të arsimit parauniversitar, me më shumë se 15 vende pjesëmarrëse, pavarësisht notës mesatare, kur pranohet në programe studimi, që lidhen me lëndën/disiplinat ku ka fituar çmimin;
- d) studentët që kanë zgjedhur një prej programeve të studimit që përbëjnë prioritet kombëtar dhe që ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare, jo më pak se 8,5.

3. Studentët aplikojnë me dokumentacionin provues, të noterizuar ose original, si më poshtë:

- a) kërkesën për aplikim;
- b) diploma dhe certifikata e Maturës Shtetërore;
- c) vërtetim nga institucioni i arsimit të lartë publik që është pranuar në një program studimi;
- d) certifikatën e fitimit të olimpiadës sipas shkronjës “c”, të pikës 2, të këtij udhëzimi.

4. Për përzgjedhjen e të gjithë kandidatëve dhe ndjekjen e ecursisë së tyre gjatë studimeve, ministri përgjegjës për arsimin cakton strukturën përkatëse për ndjekjen e procedurave të përzgjedhjes.

5. Ministria përgjegjëse për arsimin merr informacion zyrtar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) dhe/ose Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP) dhe institucionet publike të arsimit të lartë për vërtetimin e kriterëve të sipërpërmendura.

6. Për vitet në vijim, pas vitit akademik 2022–2023, MAS-i do të marrë konfirmim nga IAL-të publike për notën mesatare të studentëve përfitues, në përputhje me përcaktimet e pikës 4 të vendimit nr. 386 datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave brenda datës 30 tetor. Ky informacion do të verifikohet në raport me dokumentacionin e përcjellë nga vetë studentët përfitues, të cilët duhet të depozitojnë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, listën e notave, si dhe vërtetimin për shlyerjen e të gjithë detyrimeve të vitit paraardhës, sipas përcaktimeve të pikës 4, të vendimit nr. 386, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave.

7. Bursa financiare u jepet studentëve përfitues çdo muaj, në llogarinë bankare të deklaruar nga studentët, në bankat e nivelit të dytë, pas konfirmimit të frekuentimit të programit përkatës të studimit të struktura përgjegjëse për ndjekjen e ecurisë së studentëve gjatë studimeve, brenda datës 5 të çdo muaji.

8. MAS-i, pas marrjes së konfirmimeve përkatëse, harton listën përfundimtare, me të gjithë studentët përfitues të cilët përfitojnë, sipas pikës 10, të vendimit nr. 386, datë 1.6.2022 të Këshillit të Ministrave.

9. Lista përfundimtare me të gjithë përfituesit i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe IAL-ve publike, për nënshkrimin e marrëveshjes me studentët përfitues, brenda datës 30 nëntor, pasi të jenë njoftuar edhe studentët përfitues.

10. Kopje zyrtare e marrëveshjeve të nënshkruara, jo më vonë se dy ditë nga data e nënshkrimit, i përcillen çdo IAL-je publike, të cilat kanë studentë përfitues të këtij fondi.

11. Pas nënshkrimit të marrëveshjes trepalëshe mes përfituesit të financimit ose përfaqësuesit ligjor të tij, ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe institucionit të arsimit të lartë publik, brenda datës 15 të çdo muaji, IAL-të publike duhet të kryejnë, të cilat janë përcaktuar në marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet palëve. Masa e financimit nuk mund të tejkalojë nivelin e pagës minimale të përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, në momentin e financimit të studentit dhe vlera e saj duhet të përcaktohet në marrëveshje.

12. Studentët të cilët mund të kenë kryer pagesën e tarifës së shkollimit pranë IAL-së përkatëse, menjëherë, pas nënshkrimit të marrëveshjes trepalëshe, IAL-ja duhet të bëjë rimbursimin e tarifës së paguar nga këta studentë.

13. Fondet për mbështetjen financiare të studentëve sipas këtij udhëzimi, përballohen nga buxheti i ministrisë së arsimit dhe sportit që i akordohet IAL-ve publike, në programin 09450, në formë grandi.

14. Për mbulimin e efekteve financiare për vitin 2022, për ato IAL publike të cilat do të kenë nevojë për fonde shtesë për përballimin e efekteve financiare që burojnë nga zbatimi i këtij udhëzimi, efektet financiare do të kompensohen nga ministria përgjegjëse për arsimin.

15. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe Institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT  
**Evis Kushi**